

A red silhouette of a family walking towards the right. It includes a man carrying a child on his back, a woman, a child, and a person in a wheelchair.

UDHËZUESI PËR TË DREJTAT DHE SHËRBIMET E MIRËQENIES SOCIALE 2025

**Të gjithë mund të
përballemi me
vështirësi**

TABELA E PËRMBAJTJES

QENDRAT E SHËRBIMEVE SOCIALE NË SLLOVENI	4
UDHËZUESI PËR TË DREJTAT DHE SHËRBIMET E MIRËQENIES SOCIALE.....	6
ASISTENCË SOCIALE FINANCIARE.....	7
ASISTENCA SOCIALE FINANCIARE PËR RASTE TË JASHTËZAKONSHME	8
PAGESAT SUPLEMENTARE.....	9
PËRFITIMI PËR FËMIJËN	10
BURSAT NGA SHTETI.....	11
TARIFAT E REDUKTUARA PËR ÇERDHEN	12
SUBVENCIONI PËR QIRANË.....	13
VAKTET USHQIMORE TË SUBVENCIONUARA NË SHKOLLË	14
PROGRAMET E MBËSHTETJES PËR PERSONAT QË PËRJETOJNË VËSHTIRËSI OSE SITUATA STRESUESE TË FORMAVE TË NDRYSHME.....	15
FORMA TË TJERA TË ASISTENCËS FINANCIARE.....	16
FORMAT E ASISTENCËS.....	18
ASISTENCA E BE-SË PËR PERSONAT E PRIVUAR.....	19
PROGRAME TË TJERA TË FINANCUARA NGA BE-JA.....	20

QENDRAT E SHËRBIMEVE SOCIALE NË SLLOVENI

- | | |
|---|---|
| <p>1 CELJE
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Opekarniška cesta 15b,
3000 Celje
+386 (0)3 777 9811
gp-csd.celje@gov.si</p> | <p>5 KOROSHKKA
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Ozka ulica 1,
2380 Slovenj Gradec
+386 (0)8 181 0301
gp-csd.koros@gov.si</p> |
| <p>2 DOLENJSKA DHE BELA KRAJINA
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Resslova ulica 7b,
8000 Novo Mesto
+386 (0)7 393 2640 +386 (0)7 393 2670
gp-csd.dolbk@gov.si</p> | <p>6 LUBJANA
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Dalmatinova ulica 2,
1000 Ljubljana
+386 (0)1 475 0850
gp-csd.ljubl@gov.si</p> |
| <p>3 GORENJSKA
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Koroška cesta 21,
4000 Kranj
+386 (0)4 620 4800
gp-csd.goren@gov.si</p> | <p>7 MARIBOR
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Zagrebška Cesta 72,
2000 Maribor
+386 (0)2 250 6600
gp-csd.marib@gov.si</p> |
| <p>4 PRIMORSKA JUGORE
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Prisoje 1,
6000 Koper
+386 (0)5 663 4534
gp-csd.jprim@gov.si</p> | <p>8 SLLOVENIA QENDRORE (LINDJE)
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Masljeva ulica 3,
1230 Domžale
+386 (0)1 724 6370
gp-csd.osvzh@gov.si</p> |



- | | |
|--|--|
| <p>9 SLLOVENIA QENDRORE (PERËNDIM)
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Ljubljanska cesta 9,
1330 Kočevje
+386 (0)5 969 4419
gp-csd.oszah@gov.si</p> | <p>12 SAVINJSKO-SHALESHKA
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Stari trg 35,
3320 Velenje
+386 (0)3 777 3060
gp-csd.sasal@gov.si</p> |
| <p>10 POMURJE
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Slovenska ulica 41,
9000 Murska Sobota
+386 (0)2 585 8540
gp-csd.pomur@gov.si</p> | <p>14 PRIMORSKA VERIORE
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Delpinova ulica 18/B,
5000 Nova Gorica
+386 (0)5 330 2970
gp-csd.sprim@gov.si</p> |
| <p>11 POSAVJE
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Trg Matije Gubca 1,
8270 Krško
+386 (0)7 499 2000
gp-csd.posav@gov.si</p> | <p>15 PODRAVJE E POSHTME
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Trstenjakova ulica 5a,
2250 Ptuj
+386 (0)2 787 5600
gp-csd.sppod@gov.si</p> |
| <p>12 PRIMORSKO-NOTRANJSKA
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Novi trg 6,
6230 Postojna
+386 (0)5 700 1226
gp-csd.primn@gov.si</p> | <p>16 ZASAVJE
QENDRA E SHËRBIMEVE SOCIALE
Mestni trg 5a,
1420 Trbovlje
+386 (0)3 777 3306
gp-csd.zasav@gov.si</p> |

UDHËZUESI PËR TË DREJTAT DHE SHËRBIMET E MIRËQENIES SOCIALE

Të gjithë mund të përballemi me vështirësi

Secili prej nesh mund ta gjejë veten në situata të vështira ose stresuese sociale dhe materiale. Detyra e shtetit është që t'ju vijë në ndihmë në momente të tilla. Ky udhëzues do t'ju ndihmojë që të përcaktoni se çfarë përfitimesh financiare, subvencionesh dhe pagesash të reduktuara mund të merrni, si dhe do t'ju shpjegojë se si të ushtroni të drejtat tuaja.

Aplikoni te qendra e shërbimeve sociale që mbulon zonën ku keni vendbanimin e përhershëm. Aplikimin mund ta dorëzoni vetë personalisht, përmes postës ose përmes portalit elektronik shtetëror (e-Uprava) për përfitimet për fëmijë, për tarifa të reduktuara për çerdhen dhe për bursa nga shteti. Punonjësit socialë në qendrat e shërbimeve sociale do t'ju shpjegojnë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të drejtat tuaja, çdo kusht tjetër që lidhet me këto të drejta dhe pasojat e të kërkuarit të këtyre të drejtave. Anëtarët specialistë të stafit do t'ju ndihmojnë gjithashtu të plotësoni aplikimet e nevojshme, dhe mund t'ju drejtojnë pranë programeve dhe shërbimeve të ndryshme të projektuara për t'ju ndihmuar të tejkaloni problemet që po përjetoni.

Shënim

Të gjitha shumat e paraqitura në këtë broshurë kanë qenë të sakta për datën 1 mars 2025.

ASISTENCË SOCIALE FINANCIARE



Nuk keni burime financiare, ose ju apo familja juaj po jetoni me të ardhura të ulëta?

Asistenca sociale financiare është mekanizmi bazë dhe më i rëndësishëm që ofron shteti. Ajo u siguron një të ardhur minimale familjeve me të ardhura të ulëta që jetojnë në varfëri.

Kush e përfiton?

Asistenca sociale financiare u jepet familjeve me të ardhura të ulëta dhe personave në gjendje financiare të paqëndrueshme, deri në shumën e diferencës midis të ardhurave të tyre dhe të ardhurave minimale. Të ardhurat minimale për një person të vetëm janë 494,09 Euro. Për një familje me katër anëtarë (dy të rritur dhe dy fëmijë), ku një prej të rriturve është i punësuar dhe tjetri i papunësuar, të ardhurat minimale janë 1610,73 Euro.

Shënim

Shuma e asistencës sociale financiare varet nga numri i anëtarëve të familjes dhe statusi i tyre. Për këtë arsye, ju mund ta përfitoni edhe nëse të ardhurat tuaja i tejkalojnë 494,09 Euro dhe, në disa raste, edhe nëse jeni i punësuar dhe merrni një rrogë.

ASISTENCA SOCIALE FINANCIARE PËR RASTE TË JASHTËZAKONSHME



Keni nevojë për asistencë njëherëshe për ngrohjen dhe shpenzime të tjera urgjente? Keni nevojë për ndihmë me riparimet dhe zëvendësimet pas një fatkeqësie natyrore ose një fatkeqësie tjetër?

Asistenca sociale financiare për raste të jashtëzakonshme mund të përdoret për të mbuluar shpenzime urgjente të jetesës që një familje nuk mundet t'i mbulojë, si për shembull për faturat e energjisë elektrike, për blerjen e një makine rrobolarëse dhe/ose sobe, për blerjen e lëndës djegëse të përdorur për ngrohje dhe për artikuj të ngjashëm.

Kush e përfiton?

Shuma e asistencës së dhënë varet nga madhësia e familjes. Një person i vetëm i papunësuar mund të marrë maksimumi 494,09 Euro në një muaj të vetëm, ose maksimumi 988,18 Euro në një vit të vetëm. Një familje me katër anëtarë, me dy të rritur të papunësuar dhe dy fëmijë në moshë shkollore, mund të marrë maksimumi 1358,75 Euro në një muaj ose 2717,50 Euro në një vit. Në raste tërmetesh, stuhish të mëdha, fatkeqësish të tjera natyrore dhe ngjarjesh të forcave madhore, paguhen shuma më të mëdha (trefishi i shumës mujore në një vit të vetëm).

Shënim

Gjithashtu, mund të gëzoni të drejtën për të marrë asistencë sociale financiare në raste të jashtëzakonshme edhe nëse e tejkaloni pragun e të ardhurave për asistencën sociale të zakonshme. Kualifikueshmërinë tuaj do ta vlerësojë një punonjës social i një qendre të shërbimeve sociale.

Aplikimin për asistencë për raste të jashtëzakonshme duhet ta bëni përpara se të lindin borxhet. Arsyeja për këtë është se zakonisht asistenca nuk jepet për të shlyer borxhe që kanë lindur tashmë.

PAGESAT SUPLEMENTARE



Keni një pension shumë të ulët, jeni 63 vjeçe e lart (për gratë), ose 65 vjeç ose e lart (për burrat), nuk keni mundësi të punoni në mënyrë të përhershme ose që të punësoheni në mënyrë të përhershme dhe keni të ardhura të ulëta?

Pagesa suplementare është një e drejtë që ofrohet si shtesë ndaj asistencës sociale financiare. Merret nga qytetarët e moshuar ose nga persona që nuk kanë mundësi të punojnë në mënyrë të përhershme, ose që nuk kanë mundësi të sigurojnë mirëqenien e tyre materiale për shkak të rrethanave që shkojnë përtej kontrollit të tyre.

Kush e përfiton?

Të drejtën për pagesë suplementare e fitojnë personat e vetëm me të ardhura të barabarta ose më të ulëta se 726,31 Euro. Në këtë mënyrë, pagesa suplementare shërben edhe si një mjet për t'u ofruar asistencë pensionistëve që kanë të ardhura nga pensioni më të ulëta se kjo shumë. Ndërsa, për sa i përket asistencës sociale financiare, pragu për të përfituar një pagesë suplementare mund të jetë më i lartë dhe varet nga numri dhe statusi i anëtarëve të familjes në fjalë.

PËRFITIMI PËR FËMIJËN



Keni fëmijë?

Përfitimi për fëmijën është një pagesë bazë për familjet, që jepet si pjesë e politikës kombëtare për familjen. Përfitimi për fëmijën merret nga një prej prindërve, për një fëmijë me vendbanim të përkohshëm ose të përhershëm në Slloveni (dhe që është banor në Slloveni), deri kur të mbushë moshën 18 vjeçare.

Kush e përfiton?

Të gjitha familjet të cilat kanë të ardhura mesatare mujore neto prej 1293,36 Eurosh ose më pak për anëtar familjeje, kualifikohen për të marrë përfitimin për fëmijën. Në varësi të të ardhurave tuaja, ju mund të merrni midis 25,02 Euro dhe 143,81 Euro në muaj për një fëmijë, dhe pak më shumë për çdo fëmijë tjetër. Familjet me të ardhura më të larta marrin më pak, ndërsa familjet me të ardhurat më të ulëta marrin më shumë.

Shënim

Për fëmijët që jetojnë në një familje me një prind të vetëm, përfitimi rritet me 30% në përputhje me kategorinë e të ardhurave të familjes.

Nëse një fëmijë në moshë parashkollore, që është më i vogël se 4 vjeç, nuk shkon në çerdhe, shumta e përfitimit për fëmijën për atë fëmijë rritet me 20%.

BURSAT NGA SHTETI



E keni të vështirë të ofroni mbështetje për veten ose fëmijët tuaj gjatë arsimimit apo studimeve?

Bursat nga shteti janë menduar për nxënësit ose studentët që vijnë nga familjet me të ardhura të ulëta. Është një pagesë në para që u sigurohet këtyre nxënësve dhe studentëve për t'u mundësuar të vazhdojnë arsimimin.

Kush e përfiton?

Njësoj si përfitimi për fëmijën, të gjithë nxënësit dhe studentët nga familje që kanë të ardhura mesatare mujore neto prej 1293,36 Eurosh ose më pak për anëtar familjeje, kualifikohen për të marrë një bursë nga shteti. Në varësi të të ardhurave të familjes, vlera e bursës mund të shkojë midis 33,20 Euro dhe 137,44 Euro në muaj për çdo fëmijë nën moshën 18 vjeç, dhe midis 66,41 Euro dhe 274,87 Euro në muaj për çdo nxënës ose student mbi moshën 18 vjeç. Shuma bazë mund të rritet me anë të një shume suplementare për rezultate të mira në shkollë, një suplementi për koston e jetesës jetesën dhe një suplementi për fëmijët me bursë me aftësi të veçanta. Njësoj si përfitimi për fëmijën, të rinjtë që vijnë nga familje me të ardhura më të larta marrin më pak, ndërsa të rinjtë që vijnë nga familje me të ardhura më të ulëta marrin më shumë.

Shënim

Puna e kryer nga studentët që nuk tejkalon pagën minimale bruto mujore nuk merret parasysh gjatë llogaritjes së kualifikueshmërisë për bursë nga shteti, përfitimin për fëmijën, tarifat e reduktuara të çerdhes dhe vaktet ushqimore të subvencionuara në shkollë.

TARIFAT E REDUKTUARA PËR ÇERDHEN



A janë tarifat e çerdhes shumë të shtrenjta për buxhetin e familjes suaj?

Nëse fëmija juaj frekuenton një çerdhe publike, një çerdhe private me koncesion nga shteti ose një çerdhe private të financuar nga bashkia, ju keni më shumë gjasa të kualifikoheni për të përfituar tarifa të reduktuara për çerdhen.

Kush e përfiton?

Nëse të ardhurat mesatare mujore të familjes suaj janë 1293,36 Euro ose më pak për çdo anëtar familjeje, ju kualifikoheni për të përfituar tarifa të reduktuara për çerdhen. Në varësi të të ardhurave tuaja, mund t'ju kërkohet që të paguani nga 0% deri në 77% të tarifës aktuale.

Shënim

Nëse keni dy fëmijë në çerdhe në të njëjtën kohë, tarifat për fëmijën më të vogël hiqen. Tarifat për çerdhen hiqen edhe për fëmijën e tretë dhe çdo fëmijë të lindur më pas nga e njëjta familje.

SUBVENCIONI PËR QIRANË



Nuk ju mbetet më asgjë pasi paguani qiranë dhe kostot e strehimit?

Nëse nuk keni apartamentin tuaj dhe fitoni të ardhura të ulëta, mund të kualifikoheni për të marrë subvencion për qiranë. Ju mund të kualifikoheni nëse jeni një qiramarrës që jeton në një banesë sociale me qira, në një banesë me qira për kategori të posaçme, në një njësi rezidenciale, në një banesë të marrë me qira sipas vlerës së tregut, ose në banesën e kujdestarit.

Kush e përfiton?

Ju mund të bëni kërkesë për një subvencion qiraje sipas vlerës së tregut vetëm nëse nuk keni fituar në shortin e hedhur për banesat sociale ose nëse bashkia ku keni pasur vendbanimin e përhershëm në 12 muajt e fundit nuk ka hedhur asnjë short. Për të bërë aplikuar për subvencion qiraje, vizitoni qendrën tuaj lokale të shërbimeve sociale dhe mos harroni të merrni me vete një kopje të kontratës suaj të qirasë.

Shënim

Nëse plotësoni kushtin përkatës lidhur me të ardhurat, ju gëzoni të drejtën për subvencion qiraje. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme që të njoftoni qiradhënësin tuaj që po e merrni.

VAKTET USHQIMORE TË SUBVENCIONUARA NË SHKOLLË



Keni vështirësi me pagesën për vaktet ushqimore të fëmijës suaj në shkollë?

Ju mund të kualifikoheni për të paguar një çmim të reduktuar për vaktet ushqimore të fëmijës suaj në shkollë, ose edhe t'i përfitoni ato falas.

Kush e përfiton?

Ju gëzoni të drejtën të përfitoni falas një vakt të vogël në mëngjes dhe/ose drekën për fëmijën tuaj në moshë për shkollë fillore si në vijim: një vakt të vogël në mëngjes nëse të ardhurat tuaja mujore neto për janë 692,42 Euro ose më pak për anëtar familjeje dhe drekën nëse këto të ardhura janë 548,69 Euro ose më pak. Ju gëzoni të drejtën për subvencion deri në 50% të koston së drekës së fëmijës tuaj në moshë për shkollë fillore nëse të ardhurat tuaja mujore neto janë midis 692,42 Euro dhe 548,70 Euro për anëtar familjeje. Ju gëzoni të drejtën për një vakt të vogël mëngjesi të subvencionuar për fëmijën tuaj në moshë për shkollë nëntëvjeçare, nëse të ardhurat tuaja mesatare mujore janë 836,10 Euro ose më pak për anëtar familjeje (40% - 100%, në varësi të të ardhurave tuaja).

Shënim

Fëmijët në shkollë që janë vendosur në familje kujdestare, po kërkojnë azil ose janë të strehuar në institucione arsimore për fëmijë me nevoja të veçanta (ose në konvikte dhe frekuentojnë shkollën jashtë institucionit) gëzojnë gjithashtu të drejtën për të përfituar falas një vakt të vogël mëngjesi.

Nëse kualifikoheni për përfitimin për fëmijën ose për një bursë nga shteti, nuk është e nevojshme të dorëzoni aplikim. Kjo për arsye se subvencioni merret parasysh paraprakisht në faturat që ju dërgohen nga shkolla. Nëse nuk kualifikoheni për përfitimin për fëmijën ose bursë nga shteti, duhet të dorëzoni një aplikim të veçantë në mënyrë që ta kërkonti këtë të drejtë.

PROGRAMET E MBËSHTETJES PËR PERSONAT QË PËRJETOJNË VËSHTIRËSI OSE SITUATA STRESUESE TË FORMAVE TË NDRYSHME

Keni nevojë për ndihmë për shkak të dhunës apo abuzimit në familje, ose keni nevojë urgjente për rishtrikim? Keni nevojë për ndihmë me çështjet e kujdestarisë, keni probleme me varësinë, ose po vuani nga ndjenja e të qenit i pashpresë për shkak të rrethanave të tjera sfiduese?

Në bashkëpunim me organizatat dhe ofruesit e tjerë, qendrat e shërbimeve sociale ofrojnë një gamë shumë të gjerë programesh mbështetëse. Ofrohen shtëpi të sigurta, akomodime për raste emergjente, forma të ndryshme këshillimi dhe një larmi llojesh të tjera mbështetjeje, për t'ju ndihmuar në periudha kur jeni të shqetësuar dhe të stresuar.

Nëse gjendeni në çfarëdolloj rrethane sfiduese, kontaktoni qendrën tuaj lokale të shërbimeve sociale. Mund të paraqiteni në çdo orë brenda orarit të punës, pa lënë takim. Në raste emergjencash, do të gjeni një anëtar stafi që punon jashtë orarit zyrtar të punës. Stafi i qendrës do t'ju ndihmojë të identifikoni vështirësitë dhe problemet tuaja, do të dëgjojnë pritshmëritë që keni dhe do të sugjerojnë zgjidhje për to. Pas një bisede prezantuese, do të shpjegojnë shërbimet dhe përfitimet e mirëqenies sociale që ofrohen, dhe do t'ju shpjegojnë se si mund t'i kërkon, cilat janë detyrat tuaja si kërkues, dhe cilët rrjete dhe programe të asistencës janë të disponueshme për ju.

Shënim

Punonjësve socialë u kërkohet që të respektojnë anonimitetin dhe vullnetin e lirë të personave që kërkojnë ndihmën e tyre. Prandaj nuk duhet të ngurroni që të kërkonin ndihmë edhe nëse gjendeni në rrethana të vështira për shkak të abuzimit me substancat ose në ndonjë rrethanë tjetër të rënduar.

Nëse jeni viktimë e dhunës dhe keni frikë nga procedurat zyrtare, punonjësit socialë janë të detyruar t'ju ofrojnë ndihmë dhe mbështetje edhe nëse ju vendosni të mos ngrini ndonjë akuzë penale.

FORMA TË TJERA TË ASISTENCËS FINANCIARE

PAGESAT PËR FUNERALET dhe PËRFITIMET PËR VDEKJET

Po përballeni me humbje të ardhurash dhe shpenzime të larta funerale pas vdekjes së një personi të dashur?

PAGESAT PËR FUNERALET dhe PËRFITIMET PËR VDEKJET janë menduar për t'u ofruar asistencë anëtarëve (të menjëhershëm) të familjes së personit që ka ndërruar jetë, të cilët kualifikohen për asistencë sociale financiare ose për pagesë suplementare, ose që jetojnë me të ardhura të ulëta. Pagesat për funeralet synojnë të mbulojnë vetëm kostot e funeralit.

E DREJTA PËR TË PASUR KONTRIBUTE TË PAGUARA TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR TË DETYRUESHËM dhe E DREJTA PËR TË PASUR KONTRIBUTE TË DETYRUESHME TË PAGUARA TË SIGURIMIT SHËNDETËSOR **Jeni të pasiguruar dhe të shqetësuar për faturën që mund të merrni nga mjeku?**

Mund të dorëzoni një aplikim për pagesë suplementare pranë qendrave të shërbimeve sociale, si pjesë e aplikimit tuaj për asistencë sociale financiare, ose veçmas, në mënyrë që t'ju paguhen kontributet e sigurimit shëndetësor dhe kontributet e sigurimit shëndetësor të detyrueshëm. Këto të drejta mund të kërkojnë nga personat që nuk kanë sigurime dhe që plotësojnë kushtet për t'u kualifikuar për asistencë sociale financiare, personat që nuk kualifikohen për asistencë

sociale financiare vetëm si pasojë e veprimeve të tyre, dhe personat që kualifikohen për pagesa suplementare dhe për partnerët e tyre, me kusht që të jenë banorë të përhershëm të Sllovenisë. Edhe personat që janë vendosur në një familje kujdestare ose në kujdestari institucionale pas moshës 18 vjeçare gëzojnë të drejtën që t'u paguhen kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor.

PËRJASHTIM NGA PAGESA PËR SHËRBIMET E MIRËQENIES SOCIALE

Keni vështirësi për të paguar kostot e një shtëpie kujdesi ose të një institucioni tjetër të mirëqenies për veten tuaj ose për një familjar?

Mund të gëzoni të drejtën për një përjashtim të pjesshëm ose të plotë nga pagesa, nëse një qendër e shërbimeve sociale, bazuar në aplikimin tuaj dhe në statusin tuaj financiar, vlerëson që ju nuk i përballoni dot kostot e kujdesit.

FORMAT E ASISTENCËS

Përfitimet në para për të cilat mund të kualifikoheni:

- asistencë sociale financiare
- asistencë sociale financiare për raste të jashtëzakonshme
- pagesa suplementare
- përfitim për fëmijën
- bursa nga shteti
- e drejta për asistencë sociale financiare për raste të jashtëzakonshme për të mbuluar shpenzimet funerale (pagesë funerali)
- e drejta për asistencë sociale financiare për një rast të vetëm të jashtëzakonshëm pas vdekjes së një anëtarë të familjes (përfitim për vdekjen)

Subvencionet dhe pagesat e reduktuara që mund të përfitoni:

- tarifën e reduktuar për çerdhen
- falas ose të subvencionuara vaktet e vogla ushqimore në shkollë
- drekat falas ose të subvencionuara në shkollë
- subvencioni për qiranë
- përjashtim nga pagesa për shërbimet e mirëqenies sociale
- e drejta për kontribute të detyrueshme të paguara të sigurimit shëndetësor
- e drejta për kontribute të paguara të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm

Asistenca e BE-së për personat e privuar:

- asistencë në formën e ushqimit
- masa shoqëruese

Mirëqenia sociale dhe programe të tjera

Qendrat e shërbimeve sociale dhe OJQ-të në Slloveni ofrojnë deri në 208 programe, që mbulojnë:

- programet e rehabilitimit social për personat me varësi
- programet për shëndetin mendor
- programet për personat e pastrehë
- programet për të moshuarit
- programet për fëmijët dhe adoleshentët
- programet për parandalimin e dhunës
- programet për personat me aftësi të kufizuara
- programet për pjesëtarët e komunitetit rom
- programet e mbështetjes për familjet
- qendrat për grupmoshat e ndryshme
- programet promovionale për punë vullnetare dhe migrimet

Qendrat e shërbimeve sociale ofrojnë shërbimet e mëposhtme:

- ndihmën e parë sociale
- ndihmë personale
- mbështetje për viktimat e krimit
- ndihmë në shtëpi për familjet (ndihmë në shtëpi, shërbimet sociale)
- kujdes institucional
- udhëzim, mbrojtje dhe punësim në kushte të veçanta
- asistencë për punonjësit nga kompani, institucione dhe punëdhënës të tjerë

ASISTENCA E BE-SË PËR PERSONAT E PRIVUAR

Nuk jeni në gjendje të përballoni ushqimin?

Ju mund të kërkonti ndihmë pranë bankave të ushqimit që organizohen nga Kryqi i Kuq, Caritas-i i Sllovenisë dhe Qendra Prlekija për të Rinjtë. Këto skema janë të bashkëfinancuara nga fondet e Bashkimit Evropian dhe vijnë në formën e pakove që përmbajnë disa produkte ushqimore bazë, si miell, qumësht, makarona, oriz, vaj, perime të konservuara (fasule, domate) dhe reçel.

Ju duket sikur jeni të vetëm përballë problemeve tuaja?

Krahas shërbimeve të bankës ushqimit, Kryqi i Kuq, Caritas-i i Sllovenisë dhe Qendra Prlekija për të Rinjtë ofrojnë që të gjitha disa skema të tjera në pikat e tyre të shpërndarjes. Ata do të përpiqen t'ju ndihmojnë që t'i zgjidhni problemet tuaja personale duke i diskutuar ato me ju. Ata ofrojnë gjithashtu këshillim psikosocial për individët dhe familjet. Mund të merrni pjesë në biseda dhe programe arsimore në formën e seminareve dhe të aktiviteteve për rrjetëzuese. Përmes këtyre aktiviteteve do të mund të fitoni njohuri, të rifitoni vetëbesimin tuaj dhe të zgjeroni rrjetin tuaj social.

Kush e përfiton këtë asistencë?

Personat e papunësuar dhe personat e punësuar në vështirësi materiale, personat e prekur nga fatkeqësitë natyrore, prindërit e vetëm me një ose më shumë fëmijë, të moshuarit me pensione të ulëta, personat që jetojnë vetëm (veçanërisht personat mbi moshën 65 vjeçare), personat e pastrehë, grupet e marginalizuara (komuniteti rom, refugjatët, migrantët, etj.), si edhe individët që gjenden në situata stresuese si pasojë e sëmundjeve ose lëndimeve.

PROGRAME TË TJERA TË FINANCUARA NGA BE-JA

QENDRAT PËR GRUPMOSHA TË NDRYSHME+

Si familje ose individ, do të donit ta kalonit kohën tuaj të lirë në mënyrë më kuptimplotë?

Vizitoni qendrën tuaj më të afërt për grupmosha të ndryshme dhe merrni pjesë në aktivitete dhe programe të ndryshme për familjet, të rriturit, të rinjtë dhe fëmijët. Ka leksione, biseda, seminare dhe organizime falas, që ju ndihmojnë ta përdorni më së miri kohën tuaj të lirë. Qendrat ju japin një mundësi të shkëlqyer për të zhvilluar dhe përforcuar aftësitë tuaja, për t'u njohur me persona të tjerë dhe provuar përvoja të reja.

Mos vononi! Vizitoheni sot qendrën tuaj lokale për grupmosha të ndryshme!
<https://www.gov.si/teme/vecgeneracijski-centri/>

AKTIVIZIMI SOCIAL+

Po kërkonit sfida të reja, mundësi për zhvillim personal dhe mënyra për të rritur alternativat tuaja të punësimit?

Ju vihen në dispozicion disa aktivitete të "aktivizimit social+», që do t'ju ndihmojnë të fitoni përvoja dhe njohuri të vlefshme për zhvillimin tuaj personal dhe profesional. Mund të merrni pjesë në seminare praktike dhe programe trajnimi në një kontekst të qetë dhe me pjesëmarrjen e ofruesve lokalë. Ju do të përmirësoni njohuritë dhe aftësitë tuaja, dhe do të krijoni kontakte të rëndësishme me punëdhënësit.

Ofruesit e programeve të aktivizimit social në zonën tuaj:

<https://www.gov.si/teme/ukrepi-na-podrocju-socialnega-varstva/>.



Sofinancira
Evropska unija

PROJEKT PËR TË NXËNIT PËR TË RINJTË (PUM-O+)

Jeni 15 deri në 29 vjeç, pa arsim të mesëm dhe të papunësuar?

Atëherë, programi "PUM-O+" është i duhuri për ju! Vizitoni zyrën rajonale më të afërt të Shërbimit të Punësimit dhe merrni pjesë në një program ku profesionistë me përvojë do t'ju ndihmojnë të zhvilloni aftësi dhe njohuri të reja, do të mbështesin rikthimin tuaj në arsim dhe do t'ju ndihmojnë të përgatiteni për të hyrë me sukses në tregun e punës. Për hollësi të mëtejshme, vizitoni www.ess.gov.si.

SEMINARET EDUKATIVE+

Keni qenë të papunësuar për një kohë të gjatë? Jeni gati për këshillim të thelluar për karrierën në mënyrë individuale ose në ekip?

Fitoni njohuri dhe aftësi të reja përmes trajnimit praktik në kontekstin e një ndërmarrjeje sociale dhe me mbështetjen e një mentori dhe trajnuesi nga Shërbimi i Punësimit. Jepni vetes suaj një mundësi më të mirë në tregun e punës me ndihmën e punësimit të subvencionuar duke iu bashkuar programit "Seminaret Edukative+". Vizitoni zyrën më të afërt të Shërbimit të Punësimit, ku do t'ju shpjegojnë alternativat tuaja dhe çfarë duhet të bëni për të marrë pjesë në program.

Më shumë informacion në www.ess.gov.si.



Sofinancira
Evropska unija

MERRNI KARTËN E BE-SË PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Këshilli Kombëtar i Organizatave për Aftësitë e Kufizuara në Slloveni dhe Instituti i Planifikimit Urban i Sllovenisë kanë bashkuar forcat për të zbatuar një fushatë kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit rreth rëndësisë së integritit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, në të gjitha nivelet. Ata po fokusohen veçanërisht në pozicionin e grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, të drejtat për akses, barazi përpara ligjit, mbrojtje të integritetit personal, të jetuarit e pavarur dhe përfshirjen në komunitet, respektin për privatësinë, arsimin, shëndetin, trajnimin dhe rehabilitimin, punën dhe punësimin, standardet e përshtatshme të jetesës dhe sigurinë sociale, dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike.

Pse të mos bashkoheni me shumë të tjerë që tashmë po përfitojnë nga **Karta e BE-së për Aftësinë e Kufizuar**? Karta ju ofron shumë ulje dhe përfitime, si për shembull bileta më të lira në organizime dhe aktivitete sportive, çmime të reduktuara për librat dhe shumë më tepër. Mund ta merrni Kartën e BE-së për Aftësinë e Kufizuar, e cila është e vlefshme në çdo shtet të BE-së, në çdo njësi administrative në Slloveni, falas.

Për më shumë informacion për Kartën e BE-së për Aftësinë e Kufizuar, vizitoni www.invalidska-kartica.si.



Sofinancira
Evropska unija

TË DREJTAT PËR MIRËQENIE SOCIALE JANË TË DREJTAT TUAJA!

Dizajni dhe printimi: Tisk Žnidarič, d.o.o., botimi i katërt, maj 2025



REPUBLIKA SLOVENIJA
MINISTRSTVO ZA DELO, DRUŽINO,
SOCIALNE ZADEVE IN ENAKE MÖŽNOSTI



Sofinancira
Evropska unija

